

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E HËNË 23 MAJ 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke ndjekur diskutimet e kolegëve të maxhorancës konstatohet një inflacion me parime, me vlera, me standarde, por edhe me një thirrje, që edhe ne, deputetët e opozitës, që të jemi aq krenarë sa jeni ju, duhet të votojmë projektin tuaj. Unë do t'ju bëj një pyetje të drejtpërdrejtë: le të mos presin zhvillimet, që të shikojmë krenarinë. A bëjmë një test në seancën e sotme? A jeni ju krenarë për projektin që keni sjellë? A mund t'i bëni një krahasim hapësirës së Parkut Kombëtar të Butrintit me atë që ka qenë para 1 viti e gjysmë dhe me atë që është sot? Vendosni dy harta krah për krah dhe shikoni sa është kufizuar, ku është kufizuar, pse është kufizuar?

Më lejoni t'ju freskoj pak memorien duke ju kujtuar ndonjë parim. Po lexoja një analizë të BIRN të riprodhuar nga "Zëri i Amerikës", që flet për një kompleks turistik, i cili prek edhe ka gjurmë brenda Parkut Kombëtar të Butrintit dhe në një zonë Ramsar, ligatinë ndërkombëtare. Ju jeni në favor të këtyre parimeve? Jeni krenarë të shkëlqeni këto vlera, jo vetëm të natyrës, por siç e theksojnë edhe arkeologët të njohur, që aty ka edhe potencial arkeologjik, ndërsa ju votoni të ngrihen qendra urbane. E dyta, në hapësirën e Parkut Kombëtar të Butrintit, siç ka qenë, jo siç e bëtë ju, ka qenë edhe hapësira që është pronë e Manastirit Ortodoks të Shën Gjergjit, ku, gjithashtu, jepet leje për ndërtimin e një resorti tjetër.

Ju, që jeni krenarë për parimet tuaja, po ju them se shkelen dy parime thelbësore: e para, e drejta e shenjtë e pronës, dhe më i rëndësishëm se i pari, respektimi i shenjtërisë, që jo vetëm e shkëlqeni, por e bëni në mënyrën më profane të mundshme, në një kohë që i shkëlqeni të drejtat themelore me emrin Monastery Resort. Zotërinj, a jeni krenarë ju sot? Më pas, do ta shikojmë pas 2, 3, 4 apo 5 vjetësh se kush do të jetë krenarë? Më lejoni të qëndroj te Manastiri i Shën Gjergjit. Janë 120 hektarë. Një dosje e kompletuar, sipas të gjitha standardeve, është në strukturat private të Kryeministrit, edhe pse duhet të ishin shtetërore. Asnjë përgjigje, as jo, as po. Shikojeni më praktikisht. Çfarë ka ndodhur me pronat fetare në vendin tonë?

Ka ndodhur një krim. Janë vjedhur, janë plaçkitur nga regjimi komunist. Çfarë ndodh kur zbardhet një krim? Organet policore dhe ato të drejtësisë i kthejnë të zotit të cenuar mallin. Çfarë po bëni ju pas zbardhjes së plaçkitjes? Në një kohë që është zbardhur në mënyrë pëblishitare krimi i ateizmit të instaluar kushtetueshmërisht në vendin tonë, ju mbron produktin e krimit. Pronat që sekuestroi komunizmi, ju, si bijë shpirtërorë të denjë, vazhdoni t'i mbani sot më keq se regjimi i kaluar për interesin tuaj dhe të klientëve tuaj. A jeni krenarë ju për këtë? Këto janë fakte të njohura botërisht. Secili, që shikon një objekt të kultit mysliman, e di që është xhami, nuk do ligj, nuk do VKM që ta konstatosh. Po ashtu, një katedrale ortodokse, një sinagog, fakte të njohura botërisht, por ju jeni të verbër.

Arroganca ju ka bllokuar shqisat, nuk keni reagime. Diskutojmë me kolegët dhe ministrat në komisione, por kanë vetëm heshtje. Për një moment kujton se është heshtja e të urtit, që do të pasohet nga reflektimi, por heshtja e tyre është si ajo e shejtan budallait, që presin sa të kalojë ky rast, për të ardhur rasti tjetër abuziv. Zotërinj, meqë jam në fushën e parimeve dhe vlerave, që na i propagandoni në mënyrë sistematike sot, meqenëse është prezente edhe ministrja e Kulturës, po përfitoj nga rasti të pyes: çfarë ndodhi në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë? Janë xhiruar klipe këngësh dhe në mënyrë krejtësisht çarmatosëse drejtoresha e institucionit thotë: “Kjo është normale”, sepse janë thjesht objekte me vlera artistike, nuk kanë më vlera shenjtëruese.

Zotërinj, është pronë e grabitur dhe me çdo ligj elementar quheni “posedues të produktit të krimit” dhe dënoheni penalisht, por të paktën reagoni moralisht. Ikonostasi ka autor, ka pronar, komunitetin e Rehovës, ka brenda vlera shpirtërore, me të cilat ju nuk keni pasur dhe nuk keni për të pasur ndonjëherë lidhje. Aty ka dhimbje, ka gëzim, ka lutje, ka falënderim, ndërsa ju keni vetëm nëpërkëmbje, abuzim. A vazhdon të jetë ajo drejtoreshë ende në detyrën e saj të ngarkuar? A i keni thënë asaj t'i hedhë një sy Kodit Etik të Këshillit Botëror të Muzeve, se çfarë thuhet për objektet e komuniteteve fetare? Zonja dhe zotërinj, natyrisht që unë, në vendin tuaj, jo vetëm që nuk do të ndihesha krenar, por as nuk do të pretendoja, siç bëni ju. E kuptoj që interesat janë të mëdha, ngritja e dorës ka peshë të rëndë, por dijeni që është e së sotmes.

Dua të përsëris edhe një herë, e bëra edhe në seancën e kaluar: punët e qeverisë janë sot për sot, ato të përëndisë janë përjetë e mot. Ndoshta është momenti që të gjithë së bashku të rehabilitojmë edhe për llogari të brezave të mëparshme atë shkëlqe të paprecedentë që i është bërë të shenjtës dhe besimit tek e shenjtja në vendin tonë dhe jo të vazhdojmë ende të mbajmë produktet e krimit komunist, pronat, qofshin ato fizike, qofshin ato shpirtërore në dispozicionin e qeverisë në këmbim të marrëdhënieve profane me klientët e saj. Faleminderit!